

VENDIM
Nr. 365, datë 6.5.2020

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË
“TRAJTIMI I STUDENTËVE”, SH.A., GJIROKASTËR, NGA MINISTRIA E
FINANCave DHE EKONOMISË TE BASHKIA GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Trajtimi i studentëve”, sh.a., Gjirokastrë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkisë Gjirokastrë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama